



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN

PROJEKTI PËR PJESËMARRJE QYTETARE

LISTË FAKTESH / 2017

CEP MACEDONIA

KOMPONENTI NJË:

FORCIMI I ALEANCAVE TË ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE

PROJEKTI I USAID-IT PËR PJESËMARRJE QYTETARE (PPQ), QË FILLOI ME AKTIVITET NË GUSHT TË VITIT 2016, E FORCON PJESËMARRJEN KONSTRUKTIVE TË ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE (OSHC-VE) NË POLITIKAT DHE ÇËSHTJET ME INTERES PUBLIK, E RRIJT DHE E MBËSHTET PËRFSHIRJEN E TË RINJVE NË JETËN PUBLIKE NË MAQEDONI.

QËLLIMI I PËRGJITHSHËM I PPQ-SË ËSHTË RRIJTJA E KAPACITETIT TË OSHC-VE DHE GRUPEVE TË TË RINJVE PËR TË: AVANCUAR POLITIKAT PUBLIKE, PËRMIRËSUAR SHËRBIMET PUBLIKE, PROMOVUAR QEVERISJEN E MIRË DHE PËR TË KONTRIBUAR NË PËRMIRËSIMIN E STANDARDIT JETËSOR NË MAQEDONI.

PPQ-JA I MBËSHTET ALEANCAT E OSHC-VE QË FOKUSOHEN NË KËTO FUSHA KRYESORE:

- Sundimi i Ligjit
- Anti-korrupsioni
- të Drejtat e njeriut
- Rritja ekonomike
- Mjedis i volitshëm për zhvillim të biznesit
- Monitorim dhe mbikëqyrje e institucioneve

Aktivitetet dhe Rezultatet e Komponentit Një

Gjatë tre viteve të para të projektit, PPQ-ja do të identifikojë deri në pesë aleanca të OSHC-ve dhe do t'i mbështesë ata që të:

- *Bëhen liderë në formësimin dhe pjesëmarrjen konstruktive në çështje me interes publik;*
- *Rrisin kapacitetet e tyre për të përfshirë qytetarët, mediat, institucionet qeveritare dhe aktorët tjerë të interesuar në avancimin e mirëqenies së publikut;*
- *Forcojnë kapacitetin e tyre institucional.*

Aleancat e OSHC-ve përfshijnë koalicione ligjërish të regjistruara dhe të pa-regjistruara të OSHC-ve, platforma, rrjete dhe aleanca që përbëhen prej më tepër se pesë anëtare të OSHC-ve.

PPQ-ja është projekt pesë-vjeçar që financohet nga misioni i Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar në Maqedoni (USAID). PPQ-ja implementohet nga East West Management Institute në partneritet me Fondacioni për Internet dhe Shoqëri "Metamorfozis", Asociacioni për Iniciativa Demokratike (AID), Fondacioni për Shoqëri të Hapur në Maqedoni (FSHHM) dhe Këshilli Rinor Nacional i Maqedonisë (KRNM).

AKTIVITETET KRYESORE TË KOMPONENTIT NJË:

- Ndarje e pesë granteve për partneritet të aleancave të OSHC-ve;
- Sigurim i asistencës për zhvillim të kapaciteteve të këtyre aleancave.

REZULTATET KRYESORE QË PRITEN:

- Arritje e progresit të dukshëm në fushat kryesore të politikave si rezultat i aktiviteteve strategjike të ndërmarra nga pesë aleancat e mbështetura nga PPQ-ja;
- Zgjerim i aleancave të OSHC-ve me grupe të reja të interesit;
- Themelimi i mekanizmave dhe praktikave për gjenerim të pjesëmarrjes qytetar dhe mbështetje të iniciativave OSHC-ve prej bazës-lartë;
- Ndryshim organizativ që çon drejt themelimit të aleancave të qëndrueshme.

Kjo listë faktesh është përgatitur nga Projekti i USAID-it për Pjesëmarrje Qytetare me mbështetje të Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar. Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim nuk i reflektojnë domosdo pikëpamjet e USAID-it dhe Qeverisë së SHBA-ve.